



Npi – 01/382 datë: 29.11.2024

Në bazë të nenin 12.2 shkronja (d) nenin 17 shkronjat (i, j, k,) të ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 të datës 4 Qershor 2008); Nenet 8, 9, 11, 12, 16 dhe 17 të ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara; Nenet 6, 10, 11, 12 dhe 13 të Ligjit Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik; Ligjin Nr.04/L-125 për Shëndetësi; Ligji Nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare; Ligji Nr.04/L-032 për Arsimin para Universitar në Republikën e Kosovës; Udhëzim Administrativ Nr.08/2017, Organizimi, Struktura, Përcaktimi i Shërbimeve dhe Veprimtarise së Institucioneve të Kujdesit Paresor Shëndetësor (KPSH); Rregulloren e MAPL-së Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës; Statutin e Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 datë 03.09.2008; Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa Npi-01/379 dt.27.11.2024; Rekomandimin e Komitetit për Komunitete Npi-01/375 dt.27.11.2024; Propozimin e Zyrës së Kryetarit Nr.02/1084 dt.22.10.2024, Si dhe duke marrë parasysh procesin e diskutimit publik me qytetarë të mbajtur më 15.11.2024, Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e rregullt, të mbajtur më datën: 29.11.2024, miratoi:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË DHE PLANIN E VEPRIMIT PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË KOMUNËN E SHTIMES 2025-2028

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e -XI- të rregullt për vitin 2023, e mbajtur më: 29.11.2024, Unanimisht miratoi Strategjinë dhe Planin e Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në komunën e Shtimes 2025-2028.

II

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në evidencën e protokollit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Handikosit-Shtime, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi